



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**

R R E G U L L O R E

**PËR
MBROJTJEN, SIGURINË NË PUNË, SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS
NË SHËRBIMIN CIVIL KOMUNAL**

Prishtinë, 2011

Në bazë të dispozitave të nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 42 të Ligjit nr. 03/L - 212, për punë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 90/2010), të dispozitave të Rregullores nr. 2003/33, për Ligjin mbi sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës, të nenit 26 të Kontratës së përgjithshme kolektive të Kosovës, të nenit 33, pika 33.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2011, miratoi këtë

R R E G U L L O R E
P Ë R
MBROJTJEN, SIGURINË NË PUNË, SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS
NË SHËRBIMIN CIVIL KOMUNAL

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

1.1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është mbrojtja, siguria dhe parandalimi i lëndimeve në punë, sëmundjeve që mund të shkaktohen si pasojë e punës dhe mbrojtja e ambientit të punës.

1.2. Vendi i punës në Shërbimin civil komunal, nënkupton çdo hapësirë punuese ku kryhen punët dhe detyrat e punës.

Neni 2

2.1. Siguria në punë, mbrojtja e shëndetit të shërbyesve civilë dhe e ambientit të punës, është pjesë integrale e organizimit të punës dhe e procesit të punës. Kjo vihet në funksion nëpërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, përmes marrëveshjeve obliguese, rregullave të parapara dhe të pranuarra për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës, masave tjera shtesë dhe udhëzimeve të përcaktuara nga punëdhënësi.

Neni 3

3.1. Mënyra e organizimi dhe procesi i punës, posaçërisht në masat dhe normat e sigurisë që kanë të bëjnë me punët dhe detyrat e punës në Shërbimin civil komunal rregullohet me ligj dhe këtë rregullore.

3.2. Me rastin e riorganizimit të punës, rikonstruktimit dhe blerjes së mjeteve të reja të punës, çdoherë duhen të zbatohen dhe sigurohen masa përkatëse të sigurisë në punë.

Neni 4

4.1. Procesi i punës duhet të organizohet, në mënyrë që secili punëtor të punojë pa rrezikuar shëndetin dhe jetën e tij dhe të punëtorëve të tjerë.

4.2. Përparimi i organizimit dhe i procesit të punës, me të cilin garantohet siguria e shërbyesve civilë, është detyrë themelore e udhëheqësit të Personelit, udhëheqësve të drejtorive dhe përgjegjësve të tjerë në Shërbimin civil komunal.

Neni 5

Personat përgjegjës në Shërbimin civil komunal, bëjnë zbatimin dhe përparimin e masave të sigurisë në punë, me ndihmën profesionale të përgjegjësve për siguri në punë dhe me angazhimin e organizatave të specializuara shkencore dhe shëndetësore.

Neni 6

Të drejtat për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës, në pajtim me këtë Rregullore, i kanë:

- a) Punëmarrësit që kanë themeluar marrëdhënie pune në Shërbimin civil komunal;
- b) Personat në aftësim profesional te punëdhënësi (Shërbimin civil komunal), të cilët nuk kanë themeluar marrëdhënie pune;
- c) Personat me rikualifikim profesional dhe rehabilitim;
- d) Nxënësit dhe studentët, të cilët kryejnë punë praktike në Shërbimin civil komunal;
- e) Pjesëmarrësit në punë vullnetare dhe punë të tjera publike, të organizuara për interes të përgjithshëm;
- f) Rastet tjera të parapara me ligj dhe Kontratë të përgjithshme kolektive.

II. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E PUNËMARRËSIT

Neni 7

7.1. Punëmarrësi ka të drejtë dhe obligim për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe ambient të punës.

7.2. Punëmarrësi është i obliguar t'iu përmbahet masave të nevojshme për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës, kujdeset për sigurinë dhe shëndetin e tij / saj dhe të personave të tjerë të ndikuar nga veprimet e tij /saj në punë, shfrytëzohen në mënyrë të duhur mjetet e sigurisë: pajisjet personale mbrojtëse (PPM), ato i përdor me kujdes dhe i mban në gjendje funksionale.

7.3. Punëmarrësit duhet të kenë përgjegjësi për të siguruar mbrojtjen dhe shëndetin e të gjithë personave të ndikuar nga veprimet në punën e tyre.

Neni 8

Është e drejtë e punëmarrësve ose e organizatave të tyre (sindikata), t'i zgjedhin - emërojnë përfaqësuesit e tyre për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës. Personi i caktuar do ta mbikëqyrë zbatimin e masave të ndërmarra nga punëdhënësi dhe do të bashkëpunojë me inspektorin e punës dhe mbrojtjes në punë, në interes të punëmarrësve në sferën e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës.

Neni 9

9.1. Punëmarrësi menjëherë duhet ta njoftojë punëdhënësin e tij për çdo mangësi, rrezik shëndetësor, defekt ose ndonjë dukuri tjetër, e cila mund ta rrezikojë sigurinë e tij (saj) ose të shërbyesve tjerë civilë.

9.2. Punëmarrësi ka të drejtë ta refuzojë punën, nëse ai /ajo konsideron se ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e tij/saj. Nëse punëdhënësi konsideron se refuzimi i punës është i pabazë, menjëherë duhet ta lajmërojë inspektorin e punës.

Neni 10

Punëmarrësi bashkëpunon me punëdhënësin dhe shërbyesin civil për siguri në punë, për t'u siguruar se mjedisi i punës dhe kushtet e punës janë të sigurta dhe se masat e urdhëruara nga inspektori i punës, zbatohen nga punëdhënësi.

Neni 11

11.1. Është e drejtë e punëmarrësve dhe e organizatave të tyre, që të konsultohen me punëdhënësit, në të gjitha aspektet e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës lidhur me punën e tyre.

11.2. Punëmarrësi i shfrytëzon të gjitha makinat, pajisjet, veglat, materialin punues dhe mjetet e transportit dhe aparatet e sigurisë dhe pajisjet personale mbrojtëse (PPM), në pajtim me udhëzimet specifike të zbatimit.

Neni 12

12.1. Punëmarrësi ka të drejtë të sugjerojë përmirësimin e situatës së mbrojtjes dhe shëndetit në vendin e punës.

12.2. Punëmarrësi ka të drejtë t'i raportojë inspektorit të punës lidhur me mungesat e PPM - ve dhe masat e sigurisë në vendin e punës, në mënyrë të drejtpërdrejtë, me kusht që ata /ato të kenë bazë konkrete për të besuar se masat e mbrojtjes në punë, të zbatuara nga punëdhënësi, janë të pamjaftueshme dhe si shtesë punëdhënësi nuk e ka evituar rrezikun. Në raste të tilla nuk do të ketë pasoja për punëmarrësit.

Neni 13

Punëmarrësi është i obliguar që, pa vonesë, ta lajmërojë drejtpërdrejtë punëdhënësin ose personin tjetër të autorizuar, për çdo lëndim që i ndodh në punë.

Neni 14

Punëmarrësi është i obliguar ta lëshojë punën, nëse atë e kërkon drejtpërdrejtë punëdhënësi ose personi tjetër i autorizuar, në rast se ai/ajo:

- a) nuk i zbaton masat e parapara të sigurisë në punë;
- b) nuk i shfrytëzon mjetet e sigurisë personale në punë;
- c) nuk është i aftë për punë, sepse gjendet në gjendje të tillë psike-fizike, për shkak të së cilës rrezikon veten, punëtorët tjerë dhe mjetet e punës, dhe
- d) kur punëtori, i cili është nën ndikimin e alkoolit ose narkotikëve, nuk mund ta fillojë punën.

III. OBLIGIMET DHE PËRGJEGJËSITË E PUNËDHËNËSIT

Neni 15

15.1. Punëdhënësi është i obliguar të krijojë kushte për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës për punëmarrësit e tij/saj. Punëdhënësi është i obliguar t'i mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të lënduarve në punë dhe sëmundjeve si rezultat i pasojave të punës.

15.2. Punëdhënësi është i obliguar të organizojë dhe të ndërmarrë masa të nevojshme për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimeve, organizimit përkatës dhe masave të duhura për të siguruar dhe mirëmbajtur makinerinë, instrumentet, pajisjet, veglat, vendin e punës dhe mundësitë për të shkuar në vendin e punës.

15.3. Punëdhënësi është përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e masave për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës. Punëdhënësi kontrollon efikasitetin e masave dhe ndërmerr masat e nevojshme për përmirësim të mëtejshëm.

15.4. Punëdhënësi dhe punëmarrësi, përveç të drejtave dhe detyrave të përcaktuara me ligj, janë të obliguar t'i respektojnë edhe dispozitat e Kontratës së përgjithshme kolektive mbi sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

15.5. Punëdhënësi, në pajtim me ligjin, cakton një zyrtar për siguri në punë (agjent për siguri në punë).

Neni 16

Punëdhënësi bën vlerësim të hollësishëm mbi rreziqet e mundshme për secilin vend të punës, duke u nisur nga:

- a) konstruktimi dhe pajisjet në vendin e punës,
- b) ndikimet fizike, kimike dhe biologjike,
- c) konstruktimi, zgjedhja dhe përdorimi i mjeteve, materialit, përbërësve të pajisjeve dhe zbatimi i tyre,
- d) konstruktimi i sistemeve të punës, vëllimit, rrjedhjes së punëve, orarit të punës dhe ndikimet e ndërsjella,
- e) kualifikimi dhe trajnimi i punëmarrësve, në pajtim me standardin evropian.

Neni 17

Punëdhënësi e pajis shërbyesin civilë me PPM, i cili është paraparë për mbrojtjen kundër ekspozimit të dëmtimeve dhe rreziqeve në punë. Punëdhënësi i bartë shpenzimet dhe bën zëvendësimin e PPM - ve, në interval të rregullt kohor dhe çdo herë kur është e domosdoshme.

Neni 18

Punëdhënësi obligohet që t'i ketë mjetet themelore për dhënien e ndihmës së parë, të vendosura në një lokal emergjent afër punëmarrësve ku punojnë, i cili do të shënohet me shenjë përkatëse dalluese.

Neni 19

Punëdhënësi është i obliguar që, në rast të lëndimeve ose sëmundjes së papritur, punëmarrësit t'i sigurojë :

- a) dhënien e ndihmës së parë,
- b) evakuimin e shërbyesit civil - të lënduarit, në mënyrë adekuate me natyrën e veprimtarisë së punëdhënësit,
- c) kontaktet me shërbimin përkatëse të përcaktuara për këtë qëllim,
- d) dhënien e ndihmës urgjente,
- e) kujdesin urgjent mjekësor - të emergjencës,
- f) mbrojtjen kundër zjarrit dhe
- g) aftësimin e numrit të caktuar të punëmarrësve për dhënien e ndihmës së parë, shpëtimin dhe evakuimin e punëmarrësve në rast të rrezikut të mundshëm.

Neni 20

Punëdhënësi duhet ta informojë punëmarrësin për rreziqet në punët që kryhen nga ai/ajo. Punëdhënësi duhet t'i informojë punëmarrësit, të cilët do t'i ekspozohen rrezikut të lartë, sa më parë që të jetë e mundshme, rreth rreziqeve dhe masave për mbrojtje në punë, për të zvogëluar rrezikun. Në rast rreziku të pashmangshëm, kërcënues për vete dhe për persona tjerë, punëmarrësit i lejohet të zbatojë kundërmasa të përshtatshme, nëse nuk është aty mbikëqyrësi ose personi tjetër i autorizuar. Duke pasur parasysh trajnimin që është bërë dhe mjetet teknike në dispozicion, punëmarrësit nuk do të pësojnë dëme për akte të tilla, përveç në rastet e neglizhencës flagrante ose sabotimit të qëllimshëm.

Neni 21

21.1. Punëdhënësi duhet ta aftësojë punëmarrësin për punë, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e jetës dhe shëndetit të tij/saj, e cila parandalon fatkeqësitë në punë.

21.2. Punëdhënësi e informon menjëherë organin kompetent për të gjitha rastet e vdekjes në punë, fatkeqësitë e rënda në punë ose që kanë të bëjnë me punën, gjegjësisht për të gjitha dukuritë që mund të rrezikojnë jetën dhe shëndetin e punëmarrësve në punë ose që janë të lidhura me punën.

Neni 22

Punëdhënësi i përgjigjet punëmarrësit për dëmin e shkaktuar me rastin e lëndimit në punë dhe sëmundjen që mund të shkaktohen si pasojë e punës, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.

IV. MBROJTJA E TË RINJVE, GRAVE DHE PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 23

23.1. Gratë shtatzëna, gratë me fëmijë në moshën tre vjeçare dhe personat me aftësi të kufizuara për punë, nuk mund të sistemohen veçanërisht në punë të rënda, punë më të gjatë se orari i punës dhe në punë të natës.

23.2. Të drejtat dhe obligimet e personave, sipas pikës 1 të këtij neni, rregullohen me dispozitat e Ligjit për shërbimin civil të Kosovës dhe Kontratën e përgjithshme kolektive.

Neni 24

Në Shërbimin civil komunal, puna për femra është e ndaluar në këto vende pune:

- a) në të gjitha punët me kushte të posaçme, nëse nuk janë marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e femrave;
- b) në punët që kanë të bëjë me bartje, ngarkim-shkarkim të peshave mbi 15 kg;
- c) në punët tjera që mund të ndikojnë dëmshëm, posaçërisht me rrezik të shtuar që mund të dëmtojnë shëndetin e femrave.

Neni 25

Punonjësit me aftësi të kufizuara caktohen në punë, të cilat mund t'i kryejë para rehabilitimit profesional dhe nëse mund të punojë pa rrezik për zvogëlimin të aftësisë së mbetur të punës.

Neni 26

Vendet e punës për shërbyesit civilë me aftësi të kufizuara i cakton udhëheqësi i Personelit, në bashkëveprim me drejtorët e drejtorive.

Hapësira e punës, tualetet dhe dhomat e parapërgatitjes për punë

Neni 27

27.1 Punëdhënësi duhet të ofrojë hapësirë të nevojshme për punë, së paku **7.20 m²** për një punonjës.

27.2. Punëdhënësi duhet të ofrojë në dispozicion të shërbyesve civilë numër të mjaftueshëm të tualeteve, të femrave ndaras nga të meshkujve, dhe t'i mirëmbajë në mënyrë adekuate.

V. LËMENJTË E POSAÇËM TË SIGURISË NË PUNË, MBROJTJES SË SHËNDETIT TË SHËRBYESVE CIVILË DHE AMBIENTIT TË PUNËS

Neni 28

Lëmenjtë e posaçëm profesionalë dhe rreziqet, do të rregullohen në mënyrë të veçantë.

Ndotja e ajrit

Neni 29

29.1. Niveli i ndotjes së ajrit nga pluhuri dhe gazrat duhet të matet dhe të kontrollohet nga institucionet përkatëse të autorizuar.

29.2. Pluhuri dhe gazrat duhet të pastrohen përmes ventilimit dhe formave tjera. Punëdhënësi ka për obligim të caktojë hapësirat ku do të lejohet pirja e duhanit, të cilat do të jenë të siguruara nga rreziku i zjarrit. Hapësira ku pihet duhani duhet ta ketë shenjën përkatëse për pirjen e duhanit.

29.3. Punëdhënësi është i obliguar të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit për pije.

VI. ZHURMA, DRIDHJET, DRITA, NDRIÇIMI DHE RREZIQET NGA RRYMA, PRODHIMET KIMIKE DHE ZJARRET

Neni 30

30.1. Zhurma, dridhjet dhe drita duhet të jenë në kufijtë e lejuar në pajtim me minimumin e standardeve evropiane.

30.2. Në vendin e punës nuk guxon të ketë ndriçim të tepërt. Duhet të sigurohet ndriçim i mjaftueshëm, natyral ose artificial.

30.3. Pajisjet elektrike duhet të kenë shenjën me simbolin "CE". Instalimet e rrymës duhet të jenë në pajtim me standardet evropiane "EN".

30.4. Të gjitha substancat kimike, përfshirë: pesticidet, alkalet, acidet dhe substancat tjera korrozive, duhet të deponohen dhe të përdoren në pajtim me standardet evropiane mbi kontrollin e substancave të rrezikshme për shëndet.

30.5. Vendi i punës duhet të jetë i pajisur me mjete përkatëse kundër zjarrit, në pajtim me planin emergjent. Duhet të bëhet trajnimi i punonjësve, në pajtim me planin emergjent për përdorim të drejtë të mjeteve. Daljet emergjente duhet të jenë të shënuara dhe të kenë ndriçimin emergjent. Rruga drejt daljes emergjente duhet të mos ketë pengesa. Dyert e daljes emergjente nuk duhet të jenë të mbyllura me çelës.

30.6. Punëdhënësi që ka më shumë se 20 të punësuar, ka për obligim të ketë planin për evakuim emergjent. Nëse punët kryhen në lokale të ndryshme, për secilin lokal duhet të bëhet plani për evakuim emergjent, të cilin e harton organi kompetent komunal për siguri dhe emergjencë, nëse në atë lokal punojnë më shumë se 20 të punësuar.

VII. DOKUMENTACIONI DHE SHËNIMET

Neni 31

Punëdhënësi duhet të mbajë :

- a) certifikatat teknike, të cilat specifikojnë qartë zbatimin e rregullave të sigurisë në punë, shëndetit të shërbyesit civil dhe ambientit të punës, dhomat ndihmëse në përdorim;
- b) udhëzimet mbi përdorimin e gjithë makinerisë dhe të pajisjeve në procesin e punës dhe
- c) certifikatat, të cilat e vërtetojnë se instalimet janë në rregull dhe tregojnë qartë karakteristikat e makinerisë në përdorim, në pajtim me standardet evropiane.

Neni 32

Punëdhënësi duhet të mbajë evidencën për :

- a) programet e trajnimit të punëtorëve për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt,
- b) kontrollimin paraprak dhe periodik mjekësor të punëtorëve të përcaktuar në punë, të cilat kryhen në kushte të veçanta të punës,
- c) aksidentet në punë, rastet e lëndimeve të rënda, vdekje në punë, rastet e sëmundjeve si pasojë e punës,
- d) raportet e të gjitha vlerësimeve për rreziqet dhe masat e ndërmarra për t'i eliminuar rreziqet e tilla, dhe rezultatet e kontrollimeve mbi efikasitetin e masave të tilla, dhe
- e) ndryshimet në proceset teknologjike, të cilat rrezikojnë ose mund të paraqesin rrezik për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe mjetet e punës.

Neni 33

33.1. Secili drejtor i drejtorisë në Shërbimin civil komunal obligohet që, në kuptim të kësaj Rregulloreje, të caktojë se për cilat punë, respektivisht vende të punës, nevojiten mjete dhe pajisje (varësisht nga lloji dhe shkalla e rrezikut), të cilat do të shfrytëzohen për evitimin e ndikimit të rreziqeve dhe të dëmeve të përhershme, dhe cilat mjete për mbrojtje nga veprimet ose rreziqet e kohëpaskohshme ose afatshkurtra.

33.2. Në harmoni me pikën 1 të këtij neni, caktohen pajisjet personale të mbrojtjes (PPM) për vendet e caktuara të punës në Shërbimin civil komunal të Prishtinës.

Nr.	Vendi i punës	Lloji i mjeteve të mbrojtjes personale	Copë	Afati i përdorimit	Gardëroba e obliguar
1	Vozitës	Rroba pune vere Rroba pune dimri Këmishë Kratatë Këpucë	1 1 1 1 1	24 muaj 24 muaj 12 muaj 12 muaj 24 muaj	e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar
2	Punëtor në sigurim, byfe dhe roje nate	Rroba pune vere Rroba pune dimri Xhup të trash Këmishë Kratatë Këpucë vere Këpucë dimri	1 1 1 2 1 1 1	24 muaj 24 muaj 24 muaj 12 muaj 24 muaj 12 muaj 12 muaj	e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar
3	Zjarrfikës	Rroba pune për zjarrfikës Rroba vere Rroba dimri Rroba të asbesta Këpucë gome Maska për zjarrfikës	1 1 1 1 1 1	24 muaj 24 muaj 18 muaj 12 muaj 12 muaj 12 muaj	e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar
4	Automekanik, Autolarës, Elektricitist, Bojaxhi,	Rroba pune Mantel pune Këpucë gome Kapelë mbrojtëse Dorëza pune	1 1 1 1 1	24 muaj 18 muaj 12 muaj 12 muaj 18 muaj	e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar
5	Inspektor: sanitar, të ndërtimit, të bujqësisë, të sanitarisë, të veterinarisë, të ambientit, komunal, të komunikacionit të pylltarisë,	Rroba vere Rroba dimri Këpucë vere Këpucë dimri Çantë pune Dorëza plastike për sanitari (polivinil) Çizme gome për sanitari	1 1 1 1 1 1 1	24 muaj 24 muaj 12 muaj 12 muaj 36 muaj një për 18 muaj	e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar
6	Teknik i veterinarisë	Uniformë (mantel) Pantallona plastike Çizme për punë Maska përdorimi	1 1 1 1	06 muaj 06 muaj 12 muaj një për.	e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar
7	Likuidues i qenve endacakë	Maskë Çizme gome Veshje gjuetie	1 1 1	sipas nevojës 18 muaj 18 muaj	e obliguar e obliguar e obliguar

9	Punëtor terreni, ekspeditues, arkëtar dhe gjeodet	Rroba vere Rroba dimri Këpucë vere Këpucë dimri Çantë	1 1 1 1 1	24 muaj 24 muaj 12 muaj 12 muaj 36 muaj	e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar
10	Arkivist i materialit, Operator me kompjuter	Mantel për punë Dorëza pune	1 1	24 muaj 12 muaj	e obliguar e obliguar
11	Inspektor të tatimit në pronë	Rroba vere Rroba dimri Këpucë vere Këpucë dimri Çantë	1 1 1 1 1	24 muaj 24 muaj 12 muaj 12 muaj 36 muaj	e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar
12	Inspektor për taksën për ushtrimin e bizneseve dhe veprimtarive profesionale dhe bashkëpunëtor	Rroba vere Rroba dimri Këpucë vere Këpucë dimri Çantë	1 1 1 1 1	24 muaj 24 muaj 12 muaj 12 muaj 36 muaj	e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar e obliguar

33.3. Në uniformën e punës duhet të figurojë mbishkrimi i Komunës dhe emri i drejtorisë përkatëse.

Neni 34

34.1. Mjetet për pajisje mbrojtëse personale (PPM), të parapara me nenin 2.5 të Ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës, të përshkruara në nenin 33 të kësaj Rregulloreje, do të sigurohen nga punëdhënësi.

34.2. Për punëmarrësit, të cilët punojnë në Shërbimin e byroteknikës, të arkivit dhe zjarrfikësit me rastin e intervenimit të zjarrit, të cilët i ekspozohen gazrave, erërave, pluhurit, kushteve të përgjithshme higjienike, punëdhënësi ka për obligim të sigurojë nga 1 litër qumësht për çdo ditë pune për secilin të punësuar.

Neni 35

Pakënaqësitë lidhur me ambientin e punës dhe PPM, duhet t'i drejtohen udhëheqësit të Personelit, kurse ankesat i drejtohen Komisionit të ankesave.

Neni 36

Masat ndëshkimore do të jenë masat e përcaktuara me nenin 15 të Ligjit nr. 2003/19, për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të shërbyesve civilë dhe ambientit të punës.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 37

37.1. Punëdhënësi obligohet të sigurojë kushtet dhe masat e nevojshme të parapara me këtë Rregullore.

37.2. Për të gjitha çështjet tjera, të cilat nuk janë të përfshira në këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi.

Neni 38

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit të saj nga ana e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr.110-2631, më 16.11.2011

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.